



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M


Nr.07, datë 19.10.2022

PËR
KONFISKIMIN PËR INTERES PUBLIK TË OBJEKTIT
“OBJEKT 7 KATE, ME 2 KATE NËNTOKË”,
ME VENDNDODHJE NË RR. “HIQMET BUZI”, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të nënndarjes “iii” dhe “iv”, të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, me propozim të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Konfiskimin për interes publik të objektit “Objekt 7 kate, me 2 kate nëntokë”, të ndërtuar pa leje për qëllim fitimi, brenda sheshit të ndërtimit të objektit të miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr.M-10719/7, datë 25.07.2019 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin “Godinë banimi dhe shërbime 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 kat, me 2 dhe 3 kate parkimi nëntokë”, me vendndodhje në Rr. “Hiqmet Buzi”, Bashkia Tiranë, me zhvillues shoqëritë “Xheluks Konstruksion” sh.p.k dhe “Devis Konstruksion” sh.p.k.
2. Planvendosja e objektit të konfiskuar, bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Agjencia e Zhvillimit të Territorit të përcjellë këtë vendim pranë Ministrisë përgjegjëse në varësi të të cilës gjendet autoriteti përgjegjës për administrimin e pasurive të konfiskuara të shtetit.
4. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ose autoriteti i autorizuar prej saj të aplikojë nëpërmjet sistemit e-leje, për miratimin e një Leje Zhvillimi/Ndërtimi të re, si dhe lëshimin e Çertifikatës së Përdorimit, me qëllim rregullimin e pasojave të shkaktuara nga situata faktike, e krijuar nga ndërtimi.
5. Pas miratimit të lejes përkatëse, Bashkia Tiranë të lëshojë certifikatën e përdorimit, në përputhje me këtë vendim dhe planvendosjen bashkëlidhur.



6. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të kryejë regjistrimin e këtij vendimi, së bashku me certifikatën e përdorimit, sipas parashikimeve në VKM-në Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”.
7. rkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territor, për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ju njoftohet palëve.

MINISTËR I BRENDSHËM

BLDAR ÇUÇI



MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA FOTA

